

VENDIM
Nr. 719, datë 1.12.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
TË RI 110/20 kV, NË FUSHË - KRUIJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, me numër 294/4, në zonën kadastrale 1665, e llojit “arë”, me sipërfaqe 4 500 (katër mijë e pesëqind) m², me çmim të konfirmuar nga ATP-ja, 287 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë/m², në emër të z. Shpëtim Talip Babasi, që preket nga ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV, në Fushë - Krujë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, të vlerësuar në shumën prej 1 291 500 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekësh.

4. Pronari, për t’u likuiduar për efekt shpronësimi, duhet të dorëzojë pranë OSHEE sh.a., Tiranë, dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin bankar lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit, të shoqëruar me një kërkesë.

5. Fondi për kompensim, prej 1 291 500 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekësh, si dhe të gjitha shpenzimet procedurale të përballohen nga fondet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., si subjekti që garanton shpenzimet për realizimin këtij procesi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit dhjetor 2017.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këtë pasuri, deri në përfundim të procesit të kalimit të pronësisë së pasurive të shpronësuara në favor të OSHEE sh.a..

8. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSHEE sh.a, dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi